

URDHËR
Nr. 46, datë 17.1.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;
 - b) materialit biologjik dhe të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të rezultuar negativ, i bashkëlidhur me certifikatën shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;
 - c) mishit të freskët;
 - d) produkteve të mishit të patrajtuar me të paktën një temperaturë prej 70° C për 30 minuta;
 - e) qumështit dhe produkteve të qumështit të patrajtuar termikisht me një temperaturë minimale prej 72° C për 15 sekonda (temperaturë e lartë – kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
 - f) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara, të patrajuara ose të papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
 - g) ushqimit me përmbajtje proteinike dhe ushqimit të kafshëve ruminantë dhe derra të patrajtuar termikisht ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike,sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e ADIS-it dhe WAHIS, përkatësisht nga ndarjet administrative të tabelës së mëposhtme, të shtetit të Gjermanisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Hoppegarten*

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishit të freskët, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, qumështit, produkteve të qumështit, miellit të mishit, miellit të gjakut, leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të trajtuara dhe të papërpunuara dhe ushqimit të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari